



Komiteti Shqiptar i Helsinkit

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



Gjendja e minoriteteve në Korçë nën optikën e qytetarëve dhe të bashkisë së Korçës

Më datën 15 Nëntor 2006, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH-ja) organizoi një tryezë të rumbullakët në qytetin e Korçës për të paraqitur përfundimet kryesore të dala nga anketimi i qytetarëve në Bashkinë e Korçës lidhur me respektimin e të drejtave të minoriteteve në këtë Bashki.

KSHH-ja përzgjodhi Bashkinë e Korçës nisur nga fakti se në këtë bashki bashkëjetojnë disa minoritete (Maqedonas, Rom, Arumun dhe komuniteti Egjyptian). Nëpërmjet anketimit është synuar të bëhet: vlerësimi i punës së bashkisë Korçë nga ana e qytetarëve; vet-vlerësimi i punës së administratës bashkiake Korçë; njohja e shkallës së pjesëmarrjes së përfaqësuesve të minoriteteve në vendimmarrjen vendore; njohja e mundësive për përmirësimin e punës së administratës bashkiake në promovimin dhe respektimin e të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës.

Anketimi u krye gjatë periudhës Qershor-Shtator 2006 dhe u anketuan 480 qytetarë dhe 35 punonjës të administratës së Bashkisë Korçë.

Disa nga përfundimet kryesore të këtij anketimi ishin:

1. Qytetarët dhe administrata e Bashkisë pranojnë se ka progres në respektimin e të drejtave të minoriteteve në Bashkinë e Korçës. Në përgjithësi, Bashkia e Korçës ka marrë masa për integrimin e minoriteteve.
2. Si shërbime kryesore që ofrohen nga bashkia për promovimin e të drejtave të

minoriteteve janë vlerësuar: arsimimi, punësimi, strehimi, ndihma social-ekonomike, etj. Megjithatë, si qytetarët e intervistuar edhe administrata e Bashkisë janë shprehur se këto shërbime nuk përdoren nga ana e minoriteteve.

3. Punësimi, strehimi, arsimit, etj, janë vlerësuar si shqetësime kryesore sociale të minoriteteve në Bashkinë e Korçës.
4. Sipas të anketuarve, trajtimi i minoriteteve është i diferencuar në bazë të përkatësisë së tyre. Trajtimi ndryshe, vihet re në mundësitë për punësim, arsimim dhe në trajtimin nga ana e organeve të bashkisë.
5. Grupet më të diskriminuara në bashkinë e Korçës janë Romët dhe Egjyptianët.
6. Te punonjësit e administratës së Bashkisë Korçë që u anketuan ekziston mendimi i përgjithshëm se minoritetet nuk duhet të kenë të drejta të veçanta nga pjesa tjetër e popullsisë.
7. Niveli i besimit të qytetarëve tek organet bashkiake, në rastet kur një përfaqësues të minoritetit i shkelen të drejtat e tyre është jo i kënaqshëm.
8. Informimi i publikut nëpërmjet medias për qëndrimet e administratës vendore ndaj minoriteteve nuk është në nivelin e duhur. Pjesa më e madhe e të anketuarve janë shprehur se media ka pasqyruar rrallë si nismat e administratës bashkiake në mbështetje të minoriteteve ashtu edhe rastet e cënimit të të drejtave të minoriteteve.

Qytetarët e Bashkisë Korçë kanë kërkuar që:

- 1 Bashkia e Korçës të punojë më shumë dhe të gjendet më pranë minoriteteve me qëllim që të fitojë besueshmërinë e saj ndaj tyre.
- 2 Punësimi, strehimi, arsimit, etj, të jenë objekt i një pune të kujdeshme të bashkisë Korçë në funksion të harmonisë dhe paqes sociale.
- 3 Si qytetarët, dhe bashkia Korçë duhet të punojnë më shumë që shërbimet që ofron Bashkia të përdoren nga qytetarët, sidomos nga minoritetet.
- 4 Të anketuarit kërkojnë një pasqyrim sa më të plotë dhe objektiv të problematikës së minoriteteve në qytetin e Korçës nga ana e medias.
- 5 Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar problemit të romëve dhe egjyptianëve si komunitetet më të prekura nga tranzicioni dhe paragjykimet.

Të pranishëm në tryezë ishin anëtarë të Këshillit Bashkiak të Korçës, përfaqësues nga administrata e Bashkisë së Korçës, shoqëria civile, përfaqësues të minoriteteve në Korçë, mësues, përfaqësues nga prefektura e Korçës, Qarku i Korçës, etj. Të gjithë të pranishmit

e vlerësuan raportin e përgatitur si hapin e parë në punën e bashkisë së Korçës në të ardhmen për një respektim më të mirë të të drejtave të minoriteteve në qytetin e Korçës.

Së shpejti, KSHH-ja do të përgatisë raportin e plotë dhe përfundimtar për gjendjen e respektimit të të drejtave të minoriteteve në qytetin e Korçës nisur nga perceptimi qytetar dhe ai i administratës së Bashkisë. Ky raport do të publikohet në faqen e Internetit të KSHH-së, www.ahc.org.al, në gjuhën shqip dhe anglisht.

Pas tryezës së rumbullakët, Drejtorja Ekzekutive e KSHH-së, Znj. Vasilika Hysi, eksperti i angazhuar për realizimin e studimit, Z. Gjergji Sinani dhe kryetari i këshillit Bashkiak të Bashkisë së Korçës, Z. Gjergji Mero ishin të ftuar në një program televiziv në televizionin “Lobi”. Ata folën për studimin, përfundimet e dala nga anketimi dhe angazhimin e bashkisë në të ardhmen për një respektim më të mirë të të drejtave të minoriteteve në Korçë.

Realizimi i anketimit, tryeza e prezantimit të përfundimeve të dala prej tij dhe botimi i studimit janë realizuar në kuadër të projektit “Monitorimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në Bashkinë e Korçës”, të realizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak Korçë dhe me mbështetjen financiare të Friedrich Ebert Stiftung dhe Qeverisë Gjermane nëpërmjet Paktit të Stabilitetit, të cilët KSHH-ja dëshiron t’i falenderojë në mënyrë të veçantë.